




Planuar / Dorezuar Primijshe/Prodato Received/Delivery	22-09-2022	2	ulti god veg
Organ /Njesia Organ /Jednica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5621/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.726/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.726/2022 të datës 23.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.726/2022 të datës 23.08.2022, e parashtruar nga ankues

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 23.08.20200, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4878/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 17.08.2022 me numër Nr.1925, i nxjerrë nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Ekonomisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 25.08.2022, përmes shkresës me numër të protokollit 4972/2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Ekonomisë. Ndërsa Këshilli, me datën 30.08.2022, përmes shkresës me numër të protokollit 5038/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit nga Ministria e Ekonomisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:4878/2022 të datës 23.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.1925 të datës 17.08.2022 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; Njoftimin me numër Nr.1122 të




datës 18.05.2022 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; Njoftimin me numër Nr.1248 të datës 27.05.2022 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; Njoftimin me numër Nr.1450 të datës 22.06.2022 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; Vendimin me numër Nr.1448 të datës 22.06.2022 nga zv.Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë; Vendimin me numër Nr.1440 të datës 22.06.2022 nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë; Kërkesën për opinion ligjor përmes e-mailit zyrtar të datës 23.06.2022; Kërkesat për opinion ligjor përmes e-mailave zyrtar të datës 24.05.2022, 31.05.2022, 06.06.2022, 08.06.2022; Certifikatën nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve lidhur me riakreditimin e shoqatës së kontabilistëve dhe auditorëve të Kosovës SHKÇAK; Ankesën e ankuesit me numër Nr.1874 të datës 11.08.2022 për tek Ministria e Ekonomisë; Vendimin me numër A.nr.567/2022 të 05.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatën e ankuesit si auditor i brendshëm me numër ABC-091 të muajit janar 2022 nga SHKÇAK; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 30.08.2022 nga Ministria e Ekonomisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit të datës 30.08.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 26.11.2014.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar ankesën e ankuesit dhe shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 05.08.2022 ka nxjerrë Vendimin A.nr.567/2022, me të cilin ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesit të datës 24.06.2022, ndërsa ankesa e ankuesit e datës 23.08.2022, ka të bëjë me të njëjtën çështje e cila është vendosur nga ana e Këshillit në bazë të këtij vendimi, me ç' rast Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit si të palejuar, pasi që i njëjti pa i shtjerrë mjetet juridike të brendshme lidhur me parashtrimin e ankesës tek Njësia Përgjegjëse pas refuzimit të aplikacionit të datës 22.06.2022 nga kjo e fundit lidhur me procedurën e konkurrimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm" në Ministrinë e Ekonomisë, ka parashtruar ankesë direkt në bazë të këshillës juridike në Këshill.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e ligjshmërisë së ankesës së ankuesit, ka marrë për bazë edhe Vendimin me numër A.nr.646/2022 të datës 01.09.2022 i nxjerrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me ankesat e ankueseve S.R dhe F.J, sipas të cilit ka sqaruar se Vendimi Nr.1448 i datës 22.06.2022 i nxjerrë nga zv.Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ekonomisë për anulimin e procedurës së rekrutimit për ngritjen në detyrë lidhur me pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm", është nxjerrë në pajtim me legjislacionin në fuqi pasi që ka pasur paqartësi lidhur me kërkesat e posaçme formale për pranimin e certifikatave të auditimit pas opinioneve ligjore të ndryshme nga institucionet.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të kësaj rrethane konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 23.08.2022 në Këshill, është bërë i pamundur ose i



kotë, bazuar në konstatimet e lartcekura, e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, andaj edhe ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ lidhur me ankesën e ankuesit në pajtim edhe me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.726/2022, datë 22.09.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit,
- ❖ Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Ekonomisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.